

KRIMET DHE MASAKRAT SERBE NË KOMUNËN E DRENASIT (1998-
1999)

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I HISTORISË

NGA

FATLUM NIKA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI HISTORI

PROGRAMI: HISTORI E KOHËS SË RE

PRISHTINË

KORRIK, 2024

EKSPOZE E TEMËS

Krimet dhe masakrat serbe në komunën e Drenasit (1998-1999)

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Selim Bezeraj

Kandidati: Fatlum Nika

Trajtimi i këtij studimi me titull “*Krimet dhe masakrat serbe në komunën e Drenasit (1998-1999)*”, është i mbështetur në literaturën relevante, në intervista me të mbijetuar të masakrave, dhe dëshmitarë të këtyre krimeve dhe masakrave serbe, në burime arkivore, gazeta vendore dhe ndërkombëtare, dokumentarë të realizuar nga televizione të ndryshme me të mbijetuar të masakrave ku përmes këtij studimi do të mundohem të sjell argumente dhe fakte të reja lidhur me krimet dhe masakrat serbe në këtë komunë. Tema ndahet në katër kapituj:

Kapitulli i parë: trajton Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, aspektet e përgjithshme të saj si politike edhe ushtarake, pastaj aksionet guerile të saj në territorin e komunës së Drenasit në vitet e 90-ta e tutje e deri tek dalja e saj në publik në nëntor të vitit 1997. Pastaj ngjarjet e shkurtit të vitit 1998 pra betejën tek gjashtë lisat në Likoshan, si dhe krimet tjera gjatë muajit shkurt të kryera nga ushtria dhe policia serbe. Aspekt tjetër i trajtimit janë edhe organizimet e para ushtarake të grupeve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pas këtyre ngjarjeve në komunën e Drenasit, pra të krimeve dhe masakrave serbe.

Kapitulli i dytë: trajton masakrat e kryera nga shteti serb, ndaj popullësisë civile, qoftë në mënyrë individuale apo edhe kolektive. Masakra e parë në mënyrë individuale në Komunën e Drenasit, është vrasja dhe masakrimi i Avdullah Nikës në moshën 45 vjeçare në shkurt të vitit 1998. Vrasja e tij lidhet pikërisht me betejën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në fshatrat Likoshan dhe Qirez (fshat në Komunën e Skenderajt), ku policia serbe kishte shtuar patrullimet në këto anë të fshatrave të malit të Qyqavicës, pas vrasjes së Avdullahut. Si pasojë e këtyre patrullimeve ndeshën pashmangshëm një njësit policor serb me një njësit të ushtarëve të UÇK-së i përbërë nga 4 ushtarë të cilët ishin nën komandën e Adem Jasharit (megjithëse Ademi nuk ishte aty por kishte ardhur më vonë), të ngarkuar me detyrë për të parë situatën e popullësisë civile në këto fshatra. Pas kësaj ngjarje policia serbe si kundërpërgjigje vrasin 24 persona nga këto fshatra të Qyqavicës ku 20 nga ta ishin civil. Pas kësaj masakre kemi sulmin mbi fshatin Prekaz të Skenderajt dhe intensifikimin e operacioneve ushtarake serbe gjatë muajve mars e tutje. Në prill 1998 kemi edhe zhdukjen e

mjekut Hafir Shala i cili ende vazhdon të jetë në mes të mbi 1600 personave të zhdukurve me dhunë në Kosovë. Me 31 maj vrasja e 10 personave në Poklek të Ri. Pastaj masakra e shtatorit 1998 ndaj popullsisë civile e strehuar në malin e Qyqavicës ku edhe vritet mjeku Lec Gradica. Me 26 shtator 1998 masakrën ndaj familjës Deliu në Abri të Epërme, ku vriten dhjetra anëtarë të familjes Deliu. Me 26 tetor të vitit 1998 kemi edhe vrasjen e Shemsi Rashit Elshanit nga fshati Krajkovë i cili ishte fëmijë, u vra nga një largësi me snajper. Pastaj në vitin 1999, me masakrën e Negrocit ku u vranë dhjetra civil shqiptarë, masakra e Gllanasellës me 16 prill 1999, masakrën e Çikatovës së Vjetër me 17 prill 1999, masakrën e Poklekut të Vjetër 17 prill 1999, masakrën e Vërbocit dhe e Shtuticës me 30 prill 1999, masakra e Shavarinës(mikrotoponim mes fshatrave Çikatovë e Vjetër dhe Gllanasellë) me 1 maj 1999, si dhe masakra të tjera individuale dhe grupore.

Kapitulli i tretë: trajton aspekte të përgjithshme mbi situatën e popullsisë civile në komunën e Drenasit, nga përndjekja e familjeve nga shtëpitë e tyre dhe vendosjen e tyre nëpër male në tenda najloni, po ashtu edhe statistika të përgjithshme për krimet serbe ndaj popullsisë civile sikur shkatërrimin e pronës private dhe asaj publike nga ushtria dhe policia serbe. Poashtu edhe spitalet civile-ushtarake në komunën e Drenasit të cilat kishin rëndësi të veçantë. Në këtë kapitull kam të paraqitur situatën e popullsisë, mbajtjen peng të popullsisë civile nëpër kampe përqendrimi në Damanek, Krajkovë, Vukovc e vende tjera si dhe vrasjen e shqiptarëve në këtë komunë të cilat lëvizin nga qindra e në mijëra popullsi civile e vrarë, mes tyre meshkuj, femra, fëmijë, pleq tek të gjitha moshat. Shembull sikur fëmijët Valmir Deliu, Ejup Caraku, Fatos Muqolli, Shqipdon Bujupi, Gentiana Deliu, Mendehije Deliu, Eronita Muqolli, Lirie Muqolli, rreth 148 gjithësej në këtë komunë, po ashtu edhe të grave madje edhe shtatzëna, sikur rasti i Rukije Nebihut (Skenderaj) shtatzënë në muajin e shtatë, ose edhe sikur Luljeta Deliu shtatzënë në muajin e nëntë, si dhe të personave në moshë të shtyer si Sinan Muqolli, Rexhep Morina, Kadri Karaxha, Arif Morina, Tafil Nika e shumë të tjerë. Vrasja e intelektualëve sikurse rasti i poetit Ymer Elshanit së bashku me gjashtë anëtarë të familjes. Në bazë të disa statistikave Komuna e Drenasit është njëra nga komunat më të prekura si nga humbjet në njerëz po ashtu edhe në dëme materiale, shtëpi të djegura, dhjetra masakra kolektive, dhjetra varreza masive, qindra të zhdukur, të plagosur, të burgosur, objekte shkollore të shkatërruara, dhjetra biblioteka të shkatërruara, objekte shëndetsore, objekte tregtare, objekte fetare, e të tjera të shkatërruara terësisht.

Kapitulli i katërt: trajton vendosjen në pah të atyre të cilët kishin kryer krime dhe masakra ndaj civilëve në Drenas, pra të ushtrisë, policisë, grupeve paraushtarake e grupe tjera. Krime në këtë komunë kishin kryer pra ushtria dhe policia serbe të cilët disa dihen edhe me emra dhe mbiemra apo edhe me nofka të luftës. Krime në këtë komunë kishte kryer edhe brigada e 37 e motorizuar e cila ishte nën komandën dhe përgjegjësinë e Lubisha Dikoviqit.